



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.227/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapsirë publike, në shtyllë elektrike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa Anr.227/2019 e datës 04.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterit të kandidates në shtyllë elektrike, në rrugën “Marie Shllaku” në Kodrën e Trimave në Prishtinë, i shqiptohet gjobë në vlerë prej 3,600.00 (tremijë e gjashtëqind) euro, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 04.10.2019, nga Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 04.10.2019, aktivistët e Vetëvendosjes, rreth orës 16:00 kanë vërejtur se aktivistët e LDK-së kanë vendou ka vendosur posterin në shtyllë elektrike në vend publik, në rrugën “Marie Shllaku” në Kodrën e Trimave në Prishtinë.

Me këtë rast paraqitsi i ankesës pretendon subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka bërë shkelje të dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në përgjigjën në ankesë, subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 05.10.2019, konsiderojnë se ankesa e subjektit Lëvizjes Vetëvendosje, ka bazë, ani pse në kushte dhe rrethana me të cilën është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, dhe komunat nuk kanë arritur ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore, të krijojnë hapësira të veçanta. Më tutje subjekti politik LDK thekson se telat e shtyllës elektrike, pavarësisht faktit që është “pronë publike” në Kosovë zakonisht janë përdorur, në mungesë të hapsirave të dedikuara për këtë, për vendosjen e njoftimeve të ndryshme mbi ngjarjen dhe zhvillimin në komunën përkatse.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në përgjigjen e saj, njofton se pavarësisht kësaj ka ndërmarr masat e duhura duke evituar “shkeljen” e pretenduar nga kandidati në fjalë, duke larguar foto- posterin, dhe për këtë kandidati ka bashkangjitur provën.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), dega në Prishtinë, është vendosur në shtyllë elektrike në rrugën “Marie Shllaku” në Kodrën e Trimave në Prishtinë, në hapësira apo vende publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike* ”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana Lidhjes Demokratike Demokratike të Kosovës(LDK), është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), janë vendosur në shtylla elektrike hapësirë publike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), në përgjigjen në ankesë i datës 05.10.2019.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me Rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteri i kandidatit për deputet të këtij subjekti politik është vendosur në hapësirë publike.

Si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë, ka deklaruar se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit 3 paragrafi 2 i Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2012, shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund të shqiptohet gjobë subjektit politik nga 5,100.00 euro deri në 20,000.00 euro, për subjektet politike që kanë qenë të

përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mirëpo siç u konstatua me lart, veprimet e subjektit politik PDK, për ta përmirësuar shkeljen, ka ndikuar në uljen e lartësisë e gjobës.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1, pika c) dhe nenit 118 par. 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 227/2019 më datën 05.10.2019.

**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.